



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 05.12.2017



RAPORT PËR MUAJIN NËNTOR 2017

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçant kemi bërë inspektimin e subjekteve afariste për kontrollë të Ligjit të duhanit, duke mbajtur edhe punë kujdestarie nga dy herë në javë me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve në zbatim të këtij Ligji. Gjithashtu kontrollë e rendit të udhëtimit të Kompanive transportuese të udhëtarve dhe transportin ilegal. Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka inspektuar subjektet afarsite hoteliere për kontrollë të Ligjit të duhanit gjatë kujdestarisë në orët e mbrëmjes me qëllim që shqiptuar 23 gjopa për shkelësit e Ligjit. Gjithashtu gjatë këtij muaji ka vazhduar me inspektim të atyre shkollave ku ka hasë në parregullsi në inspektimet e mëparshme dhe ka nxjerr raport përfundimtar për gjendjen e tyre.

Inspektori i Ndërtimit ka vazhduar me kontrollë të ndërtimeve pa leje dhe gjatë këtij muaji është bërë rrënimi i dy objekteve të ndërtuara pa leje, përmes Kompanisë së rrënitit “ASS” sh.p.k.

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka bërë mbikqyerje të punimeve (në cilësinë e Organit mbikqyrës):

- në projektin për rregullimin e varrezave në fshatin Shtuticë
- në projektin për rregullimin e rrethojave të shkollës në fshatin Baicë, Abri dhe Gllanasellë.

Gjithashtu ka qenë pjesë e Komisionit për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësit natyrore duke shqyrtuar 4 kërkesa, me qëllim që është bërë raport i vlerësimit për 4 objekte të ndryshme.

Inspektorët e Tregut kanë vazhduar me kontrolla në pikat e shitjes së derivateve të naftës me qëllim të kontrolles së licencave të punës si dhe certifikatës së cilësisë së derivateve dhe ka nxjerr raport të përgjithshëm për gjendjen e tyre. Inspektori i Tregut ka qenë gjithashtu: Kryetar i Komisionit për dhënjën e Lejes Mjedisore Komunale.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim të bizneseve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të qytetarëve si dhe urdhërësë për ato subjekte të cilat nuk janë kyqur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Inspektori i Komunikacionit ka kryer kontrolla të rendit të udhëtimit të Kompanive Transportuese të udhëtarëve dhe Transportuesit ilegal.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punes në shifra për muajin tetor 2017:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Gjoha mandat.	Fletëparaqitje	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Shqyrtim i Kërkesave	Rrënim i objekteve	Mbyllje biznesi	Konfiskim targave dhe automjeteve
I.Sanitare	53	1	23		2	0	1			
I.Tregut	12	3			5	4	1		1	
I.Financiare	32									
I.komunikacionit	17			2	1		1			1+2
I.Ndërtimit	36	6			4		4	2		
I.Ambientit	24		1		7		7			
Gjithsej	174	10	24	2	19	4	14	2	1	3

Dhjetor 2017

Shef i Inspekcionit: ARIANA SADIKU